



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Për projekt-vendimin: “Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar, Bashkia Selenicë 2027–2029”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar; Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Selenicë, Bashkia Selenicë dhe Këshilli Bashkiak Selenicë njoftojnë hapjen e procesit të konsultimit publik për projekt-vendimin: “**Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar, Bashkia Selenicë 2027–2029**”.

Ky dokument synon të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit të arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Selenicë, me fokus përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore, rritjen e aksesit dhe përfshirjes së fëmijëve në arsim, përmirësimin e shërbimeve mbështetëse, planifikimin e investimeve prioritare dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet bashkisë, institucioneve arsimore, prindërve dhe komunitetit.

Procesi i konsultimit publik ka për qëllim marrjen e mendimeve, komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët, prindërit, nxënësit, drejtuesit e institucioneve arsimore, mësuesit, edukatorët, këshillat e prindërve, organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit dhe çdo palë tjetër e interesuar.

Takimi publik konsultativ do të zhvillohet më:

Datë: 15/ 07/ 2026

Ora: 10:00

Vendi: Ambientet e Bashkisë Selenicë

Projekt-dokumenti “Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar, Bashkia Selenicë 2027–2029” do të jetë i disponueshëm për publikun në faqen zyrtare të Bashkisë Selenicë, në ambientet e Bashkisë, si dhe pranë sekretariatit të Këshillit Bashkiak.

Të gjithë të interesuarit ftohen të paraqesin mendimet, komentet dhe rekomandimet e tyre me shkrim, brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik, deri më datë 15/ 07/ 2026, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- me postë elektronike në adresën: info@bashkiaselenice.gov.al;
- pranë Protokollit të Bashkisë Selenicë;
- pranë Sekretariatit të Këshillit Bashkiak Selenicë;
- gjatë takimit publik konsultativ, ku komentet do të pasqyrohen në procesverbal.

Për informacione të mëtejshme dhe për administrimin e komenteve, person kontakti është:

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Emër/Mbiemër: Bleona Haskaj

E-mail: bleona.haskaj@bashkiaselenice.gov.al

Tel: 0675130475

Bashkia Selenicë dhe Këshilli Bashkiak Selenicë ftojnë të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit të marrin pjesë aktivisht në këtë proces, me qëllim që Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar të pasqyrojë sa më mirë nevojat, prioritetet dhe pritshmëritë e komunitetit për një arsim më cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për çdo fëmijë në territorin e bashkisë.